




|   |                               |
|---|-------------------------------|
| <b>REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO</b><br><b>AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT</b><br><b>AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE</b><br><b>ANTI-CORRUPTION AGENCY</b> |                               |
| Dap.<br>Dep.<br>Dep.<br>Nr. I faq.<br>Broj stranica<br>Nr. pages  | <b>2-D   DPK</b><br><b>02</b> |
| Nr. Prot.<br>Br. Prot.<br>Prot. No  | <b>01-2492/14</b>             |
| Data<br>Datum<br>Date   | <b>03.07.2014</b>             |
| PESTINE   |                               |



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI-CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10) dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit si dhe nenin 24 (paragrafi 11) të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korruptionit (nr.01/2014), Drejtori i Agjencisë kundër Korruptionit me datë 20.06.2014, nxjerr këtë:

### V E N D I M

**I. Mbylljet rasti me Nr. AKK-03-1695-14 për z.Lorik Fejzullahu–Udhëheqës i Departamentit Qendror të Partneritetit Publiko-Privat, Ministria e Financave, për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

### A r s y e t i m

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-1695-14, për Zyrtarin e lartë, z.Lorik Fejzullahu – Udhëheqës i Departamentit Qendror të Partneritetit Publiko-Privat, Ministria e Financave dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligi Nr. 04/L-051).**

Zyrtari i lartë, z.Lorik Fejzullahu, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korruptionit (Z-D/DPK-01-1896/14), pas të cilës ai është kontaktuar nga zyrtaret e Agjencisë kundër Korruptionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur dhe për të parandaluar kështu situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Fejzullahu, është deklaruar se do t'i bëjë këto ndryshimet e kërkua e për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Ndërkohë, z.Fejzullahu, në Agjencinë kundër Korruptionit, ka dërguar një shkresë zyrtare bashkë me informacionet zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) "Informata mbi biznesin" (DPK-03-2230-14) në të cilën shihet se te biznesi privat, "Merik" sh.p.k., z.Fejzullahu, ka hequr dorë krejtësisht nga pronësia dhe nga të qenurit person i autorizuar i biznesit privat, ashtu siç e parashev edhe ligji, duke parandaluar kështu konfliktin e interesit me funksionin e tij publik – Udhëheqës i Departamentit Qendror të Partneritetit Publiko-Privat në Ministrinë e Financave.

II. Në mbështetje të nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit

